REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

**#EUvsVirus Hackathon - Iniciativa e BE për ide inovatore në përballjen e Covid19**
**2020-04-23 09:08:00**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dëshiron t'ju njoftojë rreth një iniciative të Komisionit Evropian, #EUvsVirus Hackathon, e cila synon të bashkojë individët, shoqërinë civile, politikën dhe kompanitë në sjelljen e ideve inovatore për zgjidhje afatshkurtra të sfidave më urgjente të krizës COVID-19, në fushën e shëndetit, mjekësisë, biznesit, kohezionit social, mbrojtjes së grupeve vulnerabël dhe arsimit.
Menaxhimi i përbashkët i krizave në një Evropë solidare dhe me një BE të aftë për të vepruar janë thelbësore për të ecur përpara. Kjo iniciativë do të zgjasë nga data 24-26 prill dhe më pas idetë më të mira do të promovohen përmes platformës komunitare të Këshillit Evropian të Inovacionit (EIC).
Dëshironi të zhvilloni ide së bashku me evropianët e tjerë dhe të mbështesni zbatimin e tyre? Nëse po, lutemi regjistrimin tuaj në #EUvsVirus Hackathon dhe kontribuoni si pjesëmarrës individual, mentor për një sfidë tematike ose një organizatë partnere. Bëhuni pjesë e një lëvizjeje evropiane, në të cilën shoqëria civile, biznesi dhe politika bashkojnë forcat për të zhvilluar zgjidhje pan-Evropiane për sfidat më urgjente të krizës së koronavirusit.
Regjistrimi mund të bëhet deri në fillimin e eventit më 24 prill në ?https://euvsvirus.org/?. Aty do të gjeni informacione të mëtejshme rreth Hackathon dhe mënyra të ndryshme për të kontribuar.